



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË



**RAPORT I VLERËSIMIT
TË BRENDSHËM
PËR AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË PARË
“BACHELOR” DHE CIKLIT TË DYTË “MASTER”
NË FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË**

NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Olger Brame	Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë	-----
Mariela Burda	Departamenti i Edukimit	-----
Suela Koça	Departamenti i Gjuhëve të Huaja	-----
Edlira Menkshi	Departamenti i Histori-Gjeografisë	-----
Alger Cenolli	Student - Departamenti i Gjuhëve të Huaja	-----

VITI AKADEMIK 2016– 2017

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
I - MISIONI DHE OBJEKTIVAT E FAKULTETIT	4
II - STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT	7
II - ANALIZA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE DIPLOMAVE	12
IV - PROGRAMET E STUDIMIT, ORGANIZIMI I KURRIKULAVE, KREDITET	19
V - STAFI MËSIMDHËNËS DHE MBËSHTETËS.	21
VI - KËRKIMI SHKENCOR	33
VII - KUALIFIKIMI SHKENCOR	34
VIII - STUDENTËT	38
IX-BURIME MATERIALE. LOGJISTIKA	40
X - FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE.....	43
XI - SISTEMI I BRENDSHËM I SIGURIMIT TË CILËSISË.....	43
XII - BASHKËPUNIMI KOMBËTAR, NDËRKOMBËTAR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	44
XIII. ANALIZA SWOT E FAKULTETIT	47

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

HYRJE

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit. Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVB është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar GVB për përmbushjen e detyrave. Për hartimin e këtij raporti, GVB organizoi takime me stafin akademik, administrativ, atë mbështetës si dhe me studentët.

Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën.

Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë:

- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Manuali i Vlerësimit Institucional të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri, 2016 - 2017
- Manual për Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit, APAAL 2015
- Analiza e punës mësimore –shkencore 2016-2017 për Fakultetin E Edukimit dhe Filologjisë
- Udhëzimet e MASR-së
- Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
 - Statuti i UK-së,
 - Rregullore e UK-së,
 - Rregulloret e Programeve të studimit
 - Rregullore e transferimeve
 - Planet mësimore
 - Syllabuset e lëndëve
 - Formularët e ngarkesës vjetore të stafit

I -MISIONI DHE OBJEKTIVAT E FAKULTETIT

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal; të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor , si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë. Siç dihet, Rajoni i Korçës është i njohur për traditat arsimdashëse dhe nevojat që ka ai për mësimdhënës të disiplinave të ndryshme. Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë (ish-Fakulteti i Mësuesisë), qysh nga viti 1992, ka qenë dhe mbetet burimi kryesor për plotësimin e shkollave të të gjithë rajonit me mësues të profileve të ndryshme. Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë në Universitetin e Korçës është vatra e formimit të mësuesve të rinj që po zbatojnë reformën e përgjithshme në arsimin shqiptar, prandaj dhe ka bashkëpunim të vazhdueshëm dhe mirëkuptim të plotë me Drejtorinë Arsimore Rajonale të Korçës, me Zyrat e Arsimit në rrethet e Qarkut të Korçës, çka është konkretizuar me marrëveshje dhe veprimtari të përbashkëta me interes të ndërsjelltë.

Synimet e Programeve të Studimit

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka bërë si mision të vetin zhvillimin e një procesi mësimor e kërkimor sfidues, me infrastrukturë të mirë, e cila përfshin bibliotekën (me fonde librash që shtohen herë pas here), laboratorë të ndryshëm (në përputhje me kërkesat e programeve të studimit) si dhe teknologji bashkëkohore. Misioni i Fakultetit është të sigurojë një arsimim cilësor për studentët dhe të ofrojë përgatitje profesionale në edukim, por njëkohësisht të arrihen standardet e kërkuara në tregun e punës duke ofruar programe studimit që formojnë specialistë dhe mësimdhënës në drejtime të ndryshme (në varësi të programeve të studimit) Studentët përgatiten dhe diplomohen për një spektër të gjerë njohurish, e cila i ndihmon në zhvillimin e karrierës së ardhme dhe mbi të gjitha përgatiten si individë ndikues dhe kontribues në shoqëri përmes dijeve dhe shërbimit. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka një strategji afatshkurtër dhe një strategji afatgjatë për përmbushjen e synimeve dhe qëllimeve të mishëruara në vizionin dhe misionin e tij. Drejtimet strategjike identifikohen dhe shprehen nëpërmjet një sërë

objektivash të ndërlidhura ku mes të tjerash synohet rritja e cilësisë së diplomave që jepen dhe rritja e cilësisë së kërkimit shkencor.

Objektivat e përgjithshme

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ofron një numër të madh programesh studimi të ciklit të parë si: Mësuesi për arsimin parashkollor, Mësuesi për arsimin fillor, Gjuhë angleze, Gjuhë dhe kulturë frënge, Gjuhë –Letërsi dhe Histori –Gjeografi, si dhe programe studimi të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave. Objektivi kryesor i programeve të studimit është t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme dhe bazë për formimin e tyre profesional, si dhe për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në fushat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Sipas specifikave përkatëse, objektivat që synojnë të arrijnë këto programe studimi dhe realizimi i tyre parqitet si më poshtë:

- ✓ ofrimin e programeve të studimit që formojnë specialistë në fushat e edukimit si dhe në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit.
- ✓ forcimin e strukturave të të nxënit gjatë gjithë jetës nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të njohurive për mësuesit në detyrë.
- ✓ rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe vënien e tij në dispozicion të mësimdhënies, si dhe të zhvillimit shoqëror dhe kulturor të rajonit.
- ✓ ofrimin e njohurive të qëndrueshme që synojnë rritjen e cilësisë së diplomave që jepen dhe formimin e një brezi punonjësish dhe qytetarësh të aftë të përballen me sfidat e një shoqërie në zhvillim.
- ✓ sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së brendshme dhe rritjen e konkurrencës së diplomave në kontekstin e arsimit të lartë në vend, si dhe në kontekstin e arsimit të lartë në përgjithësi.
- ✓ formimi i kompetencave gjuhësore, shkencore, psiko-pedagogjike, të cilat përputhen me kërkesat e një shoqërie të zhvilluar, për punësim dhe për ruajtjen e vlerave kulturore si dhe të interesave kombëtare;
- ✓ nxitja e mendimit kritik përmes një kurrikule me bazë kompetencat e të nxënit;
- ✓ pajisja me aftësi të hulumtimit të burimeve të informacionit, të përpunimit të të dhënave dhe të analizës.
- ✓ përgatitja e mësimdhënësve të suksesshëm të gjuhëve të huaja, histori-gjeografisë, gjuhë-letërsisë etj me aftësi të thella profesionale dhe cilësi morale, të aftë të përballen me sfidat e një shoqërie në zhvillim;
- ✓ formimi shkencor dhe profesional i këtyre mësuesve, të aftë për t’iu përgjigjur në mënyrë konkrete kërkesave të realitetit shqiptar të arsimit parauniversitar, duke përdorur metoda dhe mjete të përshtatshme për nevojat e nxënësve si dhe për të ndihmuar edukimin e tyre ndërkulturor.

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN:

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në përputhje me kërkesat e tregut në rajon dhe më gjerë.

Diplomat e nivelit **BACHELOR** mundësojnë hapin e parë drejt profesionit të mësuesit, por njëkohësisht mundësojnë vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, në programe që lidhen me gjuhësinë, mësuesinë, trashëgiminë dhe kulturën. Këto diploma mundësojnë gjithashtu një gamë të gjerë punësimi të studentëve në tregun e punës që kërkojnë aftësi të mira në përkthim, hulumtime gjuhësore, administrim publik, marrëdhënie ndërkombëtare, marrëdhënie publike, media dhe turizëm.

Diploma e ciklit **MASTER PROFESIONAL** ofron mundësi punësimi si mësues në insitucione publike dhe jopublike të arsimit të mesëm të lartë, si specialist pranë drejtorive arsimore, trajnues pranë qendrave të kualifikimit të mësuesve, guidë turistike, ciceronë, si dhe në sektorë të tjerë të veprimtarisë edukative arsimore.

Programet e studimit **MASTER I SHKENCAVE** ofrojnë studimet të thelluara të njohurive teorike dhe aftësi për kërkim të avancuar dhe të pavarur shkencor. Qëllimi është pajisja e studentit me mjetet, aftësitë dhe mundësinë për të zhvilluar një karrierë të suksesshme profesionale dhe akademike. Në përfundim të programit Masteri i Shkencave studentit i lind e drejta të vazhdojë më tej studimet e ciklit të tretë, Doktoraturë në fushën përkatëse.

PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, 180 KREDITE (ME KOHË TË PLOTË)

Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë ofrohen 6 programe të ciklit të parë Bachelor, me kohë të plotë, me 180 kredite.

Nr.	Programi i studimit	Nr. i vendimit të hapjes
1	Mësuesi për arsimin parashkollor	VKM. Nr. 369, dt. 10. 07. 1995
2	Mësuesi për arsimin fillor Klasa I-V	Urdhër Nr. 81, dt. 25. 02. 2013
3	Gjuhë angleze	VKM Nr.300, dt.21. 06. 1994
4	Gjuhë dhe kulturë frënge	Urdhër Nr.273, dt.20. 07. 2015 VKA Nr.56 , dt. 29. 06. 2015
5	Gjuhë –Letërsi	VKM Nr. 402, dt. 25. 5. 2005
6	Histori –Gjeografi	VKM Nr.352, dt. 12. 05. 2010

PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”, 90 KREDITE (ME KOHË TË PLOTË)

Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë ofrohen 3 programe të ciklit të dytë “Master Profesional”, me kohë të plotë, me 90 kredite. Programet e studimit të ciklit të dytë kanë si qëllim zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve dhe edukimin e kompetencave specifike për fushën. Njohja me zhvillimet më të fundit në fushën e mësimdhënies dhe aftësimin e tyre për zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv të aftësive komunikuese në seminare dhe në praktikën mësimore të vëzhguar në shkollë.

Nr	Programi i studimit	Nr. i vendimit të hapjes
1	“Master Profesional”, Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë në gjuhë angleze me profil minor “Arte”.	VKM Nr.399, dt. 07. 10. 2014
2	“Master Profesional” Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë në gjuhë-letërsi me profil minor “Arte”.	Urdhër Nr. 34, dt. 26. 01. 2011
3	“Master Profesional” Mësuesi në Histori – Gjeografi”	VKM Nr.744 dt. 05. 09. 2013

PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”, 90 KREDITE (ME KOHË TË PLOTË)

Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë ofrohet 1 program i ciklit të dytë “Master i Shkencave”, me kohë të plotë, me 120 kredite.

Nr	Programi i studimit	Nr. i vendimit të hapjes së programit
1.	Master i Shkencave në Mësuesi në Arsimin Fillor klasa I-VI	Urdhër Nr. 599, Dt. 07.12.2012

Nëpërmjet këtyre programeve synohet zhvillimi i perspektivës teorike të studentëve, thellimi i mëtejshëm i tyre në kërkim dhe edukimi i kompetencave specifike për fushën e studimit. Synohet njëkohësisht edhe përgatitja e studentit me aftësitë dhe kompetencat profesionale për të dalë në tregun e punës.

II - STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

Historiku i Fakultetit

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë u hap në bazë të Urdhrit nr. 16, datë 17.1.2012 të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës dhe në nenin

41 të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky fakultet erdhi si nevojë e një riorganizimi të Fakultetit të Mësuesisë (Fakulteti i Pedagogjisë, me programin e studimit 3-vjeçar “Mësues për Arsimin Fillor”), i themeluar në vitin 1992, me **Vendimin nr. 5, datë 7 janar 1992** të Këshillit të Ministrave. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë funksionon në përputhje me kërkesat e “Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, detyrimeve të procesit të Bolonjës dhe sfidave të garantimit të cilësisë në çdo hallkë e aktivitet të tij.

Qysh prej vitit akademik 2008 – 2009 Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ofron programe studimi të ciklit të dytë, ndërkohë që në këtë vit akademik shënohet 25-vjetori i këtij fakulteti. Nga pikëpamja organizative, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë përbëhet nga Dekani, Zv.Dekani, katër departamente dhe një grup mësimor:

- **DEPARTAMENTI I EDUKIMIT**

Departamenti i Edukimit ka në përbërje të tij **9** pedagogë efektivë nga të cilët: **2** Prof.as.dr.; **3** Doktor shkencash; **1** Docent , **3** Msc. (në proces doktorature).

- **DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka aktualisht **17** pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët: **1** Prof.as.dr, **13** Dr, **1**PhD., **2** Doc. Pjesë përbërëse e departamentit të gjuhëve të huaja është edhe **GRUPI MËSIMOR I GJUHËSISË** pranë këtij departamenti.

- **DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË**

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë ka në përbërje të tij **12** pedagogë efektivë, nga të cilët: **1** Prof.dr., **4** Prof.as.dr, **4** Doktorë Shkencash, **1** PhD, **2** Msc. (në proces doktorature).

- **DEPARTAMENTI I HISTORISË DHE I GJEOGRAFISË**

Departamenti Histori-Gjeografi ka në përbërje të tij **11** anëtarë; Stafi akademik përbëhet nga: **1** Prof.as.dr, **1** Phd, **8** Doktorë shkencash dhe **1** Msc. (në proces doktorature).

Përveç stafit akademik, në fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë zhvillon veprimtarinë mbështetëse edhe stafi administrativ, i përbërë nga 6 punonjës, konkretisht: ndihmësja e dekanit, sekretaria mësimore (2 punonjëse), qendra e informimit të studentëve (2 punonjëse), punonjës biblioteke (1 punonjës).

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka aktualisht 55 punonjës: 49 punonjës staf akademik dhe 6 punonjës ndihmës mësimorë (Ndihmëse e dekanit, sekretare mësimore, sekretare departamentesh), 1 punonjës biblioteke. Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë bëjnë pjesë 49 pedagogë të brendshëm prej të cilëve një **1** mban titullin Profesor, **8** janë Profesorë të

asociuar, 3 PhD, 28 Doktorë shkencash, 3 Docentë, si dhe 6 me gradën Master i Shkencave (në proces doktore).

Tabela 1. Shpërndarja e stafit akademik sipas departamenteve

Nr	Departamenti i:	Nr. i stafit	Prof.dr.	Prof.as.dr.	PhD	Dr.	Doc.	Msc.
1	Edukimit	9	-	2	-	3	1	3
2	Gjuhëve të Huaja	17	-	1	1	13	2	-
3	Gjuhës dhe Letërsisë	12	1	4	1	4	-	2
4	Historisë dhe Gjeografisë	11	-	1	1	8	-	1
Σ	Gjithsej	49	1	8	3	28	3	6

Tabela 2. Staf i ndihmës mësimor në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë


Nr	Njësia administrative	Nr.punonjës
1	Ndihmësja e Dekanit	1
2	Sekretaria mësimore	2
3	Zyra e informimit dhe orientimit të studentëve	2
4	Biblioteka	1

Tabela 3. Përmbledhëse e shpërndarja e stafit akademik dhe ndihmësakademik në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë

Staf drejtues	Staf akademik (+ staf drejtues)	Stafi administrativ
Prof.as.dr. Pavllo Cicko Dekan Dr.Alba Kreka Zëvendësdekan Prof.as.dr.Irena Nikaj Përgjegjës Departamenti i Edukimit Prof.as.dr. Jonela Spaho Përgjegjës Departamenti i Gjuhë-Letërsisë Dr. Benita Stavre Përgjegjës Departamenti i Gjuhëve të Huaja	1. Prof. dr. Ali Jashari (Rektori) 2. Prof.as.dr. Pavllo Cicko 3. Prof.as.dr. Irena Nikaj 4. Prof.as.dr. Jonela Spaho 5. Prof. as. dr. Elona Çeçe 6. Prof.as.dr. Aleksandra Piluri 7. Prof. as. dr. Dion Tushi 8. Prof. as. dr. Anyla Saraçi 9. Prof. as. dr. Bashkim Jahollari 10. Phd. Daniela Stoica 11. Phd. Metin Venxha 12. Phd. Arsinela Xhara 13. Dr.Doc.Donika Dardha 14. Dr. Erinda Papa 15. Dr. Suela Koça 16. Dr. Benita Stavre 17. Dr. Albina Pajo 18. Dr. Alda Cicko 19. Dr. Liri Seitllari 20. Dr. Erjola Qafzezi 21. Dr. Lindita Kaçani	Teuta Naslazi Kryesekretare Engjëllushe Frashëri Sekretare Vilma Mosko Sekretare Zyra e orientimit dhe informimit të studentëve Enela Pepaj Sekretare Zyra e orientimit dhe informimit të studentëve Maria Tanushi Ndihmëse e Dekanit Edmond Tole

<p>PhD. Metin Venxha Përgjegjës Departamenti i Histori- Gjeografisë</p>	<p>22. Dr. Olsa Pema 23. Dr. Fabiola Kadiu 24. Dr. Ilir Shyta 25. Dr. Eris Rusi 26. Dr. Hysnie Hyska 27. Dr. Edlira Xega 28. Dr. Juliana Çyfeku 29. Dr. Alma Karasaliu 30. Dr. Dorela Konomi 31. Dr. Lorena Robo 32. Dr. Edlira Menkshi 33. Dr. Florina Pazari 34. Dr. Alba Kreka 35. Dr. Lindita Kiri 36. Dr. Ermira Jashiku 37. Dr. Orjon Ago 38. Dr. Ardiana Mici 39. Dr. Ermiona Braholli 40. Dr. Evionda Pylli 41. Doc. Mariela Burda 42. Doc. Vasilika Pojani 43. Doc. Robert Stratobërdha 44. Msc. Olger Brame 45. Msc. Neli Naço 46. Msc. Anjeza Vila 47. Msc. Arjan Kamburi 48. Msc. Ilia Bello 49. Msc. Adelina Nexhipi</p>	<p>Përgjegjës biblioteke</p>
--	---	------------------------------


Grafiku 1. Shpërndarja në % e stafit akademik sipas titujve dhe gradave



STUDIME TË FORMIMIT TË VAZHDUAR. QENDRA E EKSELENCËS "FEF"

Qendra e Ekselencës “FEF” në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë ka për qëllim zhvillimin e veprimtarive të trajnimit dhe të kualifikimit të mësuesve. Veprimtaria e kësaj qendre përqendrohet në zhvillimin e shprehive të mësimdhënies dhe inovacionit në edukim, në mënyrat dhe praktikat e zhvillimit profesional të mësuesve, në rikonceptualizimin e partneritetit me shkollën etj. Ajo është institucioni qendror për kualifikimin e personelit pedagogjik në shkollat e rajonit të Korçës dhe më gjerë. Qendra e Ekselencës “FEF” siguron një bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe me Zyrat Arsimore në rrethe. Ajo ofron programe trajnimi në rreth 8 profile të mësuesve në shërbim, programe që mbështesin dhe sigurojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përsosjes së saj, si dhe aplikime të risive në fushën e mësimdhënies. Qendra e Ekselencës “FEF” e ka selinë në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë dhe ka një infrastrukturë moderne për kualifikimin e mësuesve. Qendra e Ekselencës “FEF” ka një koordinator (përgjegjës), pedagog, si dhe lektorë (pedagogë të kualifikuar dhe me përvojë mësimdhënieje), nga departamentet e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, sipas profileve që mbulojnë. Gjatë vitit 2016-2017, si pasojë e ristrukturimit të kuadrit ligjor të qendrave për formimin e vazhduar nga MASR-ja dhe IZHA, kjo qendër e ka zhvilluar veprimtarinë e saj trajnuese nëpërmjet projekteve me MAS-in dhe OJF të ndryshme.

Struktura e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë jepet në organogramën e mëposhtme: ORGANOGRAMA



II - ANALIZA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE DIPLOMAVE

a) *Diplomat.*

Diplomat “**Bachelor**”. Fakulteti jep diploma për këto programe studimi Bachelor me emërtimet:

Diploma " Bachelor” në Mësuesi për Arsimin Parashkollor
Diploma " Bachelor” në Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-V
Diploma " Bachelor” në Gjuhë-Letërsi
Diploma " Bachelor” në Gjuhë Angleze
Diploma " Bachelor” në Gjuhë dhe Kulturë Frënge
Diploma " Bachelor” në Histori-Gjeografi

Diplomat “**Master Profesional**”. Fakulteti jep diploma për këto programe studimi “Master Profesional” me emërtimet:

Diploma “Master profesional” Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë në Gjuhë Angleze me profil minor “Arte”
Diploma “Master profesional” Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë në Gjuhë- Letërsi me profil minor “Arte”
Diploma “Master profesional” Mësuesi në Histori Gjeografi

Diplomat “**Master i Shkencave**”. Fakulteti jep diploma për këto programe studimi “Master i Shkencave” me emërtimet:

Diploma “Master i Shkencave” në Mësuesi në Arsimin Fillor klasa I-VI
--

Sipas specifikave përkatëse, objektivat që synojnë të arrijnë këto programe studimi janë kryesisht:

Mësuesi për arsimin parashkollor

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor synon t`u japë studentëve njohuritë dhe kompetencat themelore për formimin e tyre si edukatorë të arsimit parashkollor. Ky program studimi synon përgatitjen e mësuesve të arsimit parashkollor, duke formuar tek ata kopetencat shkencore, psikopedagogjike, gjuhësore, sistemike dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat do të përmbushin objektivat e arsimit në shoqërinë e dijes dhe për punësim. Mësuesi për arsimin fillor Klasa I-V Programi synon të përgatisë

mësues për arsimin fillor me një formim të lartë teoriko-praktik, të aftë për t`iu përgjigjur me sukses proceseve reformuese në sistemin arsimor dhe kërkesave të tregut të punës për punonjës arsimor të nesërm me kompetenca të larta profesionale.

Mësuesi për Arsimi Fillor

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimi Fillor synon t`u japë studentëve njohuritë bazë dhe të zbatuara për formimin e tyre si mësues të ardhshëm të arsimit fillor, duke ofruar njohuri teorike për një gamë shkencash si: shkencat shoqërore, natyrore dhe artet e aplikuara si dhe

formimin e shprehive të veçanta praktike që përfshijnë zbatimin e njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët

Gjuhë angleze

Programi synon t’u japë studentëve njohuritë bazë për gjuhën angleze dhe kulturën angleze dhe amerikane, si dhe njohuri për shkencën e gjuhësisë, për historinë e letërsisë, koncepte që lidhen me studimin e letërsisë dhe të kulturës, veçanërisht asaj angleze dhe amerikane. Programi synon që t’i përgatisë studentët të jetë të gatshëm për të ndjekur programet e studimit për mësues të ardhshëm të gjuhës angleze për shkollat në sistemin arsimor parauniversitar dhe programet e studimit që lidhen me veprimtarinë e mëtejshme në kërkimin shkencor. Gjuhë dhe kulturë frënge Programi synon t’u japë studentëve njohuritë bazë për gjuhën dhe kulturën frënge, si dhe njohuri për shkencën e gjuhësisë, për historinë e letërsisë, koncepte që lidhen me studimin e letërsisë dhe të kulturës, veçanërisht asaj frënge. Gjithashtu do të jepen njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshme, në drejtime të tjera studimi ngushtësisht të lidhura me natyrën e gjuhës dhe letërsisë frënge. Programi synon që t’i përgatisë studentët të jetë të gatshëm për të ndjekur programet e studimit për mësues të ardhshëm të gjuhës frënge për shkollat në sistemin arsimor parauniversitar dhe programet e studimit që lidhen me veprimtarinë e mëtejshme në kërkimin shkencor

Gjuhë –Letërsi

Programi i studimit Gjuhë dhe Letërsi synon të japë njohuritë bazë për gjuhën shqipe dhe shkencën e gjuhësisë, si dhe për historinë e letërsisë (shqiptare dhe botërore) dhe shkencës për letërsinë. Programi jep njohuri plotësuese për ato

fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshme, në drejtime të tjera studimi ngushtësisht të lidhura me natyrën e gjuhës dhe letërsisë. Studenti do të jetë i gatshëm për të ndjekur programet e studimit për mësues të ardhshëm të gjuhës shqipe dhe letërsisë për shkollat në sistemin arsimor parauniversitar dhe programet e studimit që lidhen me veprimtarinë e mëtejshme në kërkimin shkencor dhe fusha të tjera që lidhen me përdorimin e njohurive të gjuhës shqipe dhe letërsisë.

Histori – Gjeografi

Programi synon t’u japë studentëve njohuritë bazë për të formuar specialistë të së nesërme në disiplinat e historisë dhe gjeografisë, duke ofruar njohuritë bazë për historinë, studimin e saj dhe gjeografinë, për historinë e Shqipërisë dhe atë botërore. Programi synon të përgatisë studentë të aftë të cilët të jenë në gjendje t’u përshtaten sa më mirë ndryshime që pëson sistemi ynë arsimor, si dhe t’i pajisë me njohuritë e nevojshme për formimin e tyre teorik dhe njëkohësisht atyre t’u kultivojë dëshirën dhe vullnetin për punë studimore – kërkimore. Studenti do të jetë i gatshëm për të ndjekur programet e studimit për mësues të ardhshëm të historisë dhe gjeografisë për shkollat në sistemin arsimor parauniversitar dhe programet e studimit që lidhen me veprimtarinë e mëtejshme në kërkimin shkencor dhe fusha të tjera që lidhen me historinë, arkeologjinë, trashëgiminë kulturore, turizmin etj.

“Master Profesional”, Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë në gjuhë angleze me profil minor “Arte”

Ky program ofron mundësi për t’u punësuar në shkollat publike dhe private të arsimit parauniversitar, si dhe në sektorët e tjerë të veprimtarisë edukative dhe shoqërore. Programi synon të përgatisë mësues të suksesshëm të gjuhës

angleze, me aftësi të thella profesionale dhe cilësi të larta morale dhe shoqërore për t’u kthyer në modele frymëzuese për nxënësit, të përgatisë mësimdhënës si njerëz të aftë për të punuar dhe për të ndihmuar në komunitet, të përgatisë mësimdhënës të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e rajonit dhe më gjerë për të ndihmuar në zhvillimin e tyre.

“Master Profesional” Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë në gjuhë- letërsi me profil minor “Arte”

Ky program ofron mundësi për t’u punësuar në shkollat publike dhe private të arsimit parauniversitar, si dhe në sektorët e tjerë të veprimtarisë edukative dhe shoqërore, duke synuar të përgatisë mësues të gjuhës shqipe dhe të letërsisë me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në mësimdhënien në shkollat 9- vjeçare dhe të mesme, duke zbatuar teorinë dhe praktikën e arsimit në lidhje me karakteristikat e grupmoshave, përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e mësuesit si profesionist në një kontekst social në ndryshim.. Ndërgjegjësimi i studentëve në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të përgjegjësiave të tyre personale në përfshirjen në punë të pavarur kërkimore-shkencore, si dhe vlerësimin kritik të informacionit dhe të dhënave.

“Master Profesional” Mësuesi në Histori –Gjeografi”

Ky program ofron mundësi për t’u punësuar në shkollat publike dhe private të arsimit parauniversitar, si dhe në sektorët e tjerë të veprimtarisë edukative dhe shoqërore, jep mundësi kandidatit që të

përfitojë kompetencat e nevojshme për të ushtruar me sukses profesionin e mësuesit në lëndën e historisë dhe gjeografisë, në një kontekst social-kulturor në ndryshim. Programi parashikon të mbështesë kandidatin për mësues me qëllim që të zotërojë njohuri të plota të përmbajtjes dhe kurrikulumit lëndor për të siguruar një mësimdhënie të efektshme në fushat përkatëse të specialitetit .

Master i Shkencave në Mësuesi në Arsimin Fillor klasa I-V

Ky program synon përgatitjen e mësuesve të arsimit fillor me koncepte, aftësi dhe vlera bashkëkohore të planifikimit, drejtimit, organizimit dhe administrimit të veprimtarive mësimore në shkollë që të mund të kontribuojnë në sektorin publik e privat dhe njëkohësisht të jenë qytetarë aktivë në jetën e tyre të përditshme. Programi synon dhënien e njohurive specifike të studentët, mbi bazën e arsimit paraardhës të tyre, duke i formuar ata me kompetenca që iu korrespondojnë niveleve të kualifikuara të punësimit dhe të përgatitjes së tyre, trajnimit për kërkim shkencor nëpërmjet njohjes së metodave, instrumenteve e teknikave të kërkimit. Studentët mësues të nesërm përgatiten për të kuptuar shkollën dhe shoqërinë në aspekte të ndryshme, jo vetëm për t’u përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe për të qenë në korrent me zhvillimet e reja, por mbi të gjitha për një formësim profesional që u krijon hapësira të gjera punësimi në arsim.

b) Struktura didaktike për Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë

Struktura për sistemin 3-vjeçar të studimit (Bachelor) të fakultetit është si më poshtë:

Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 simestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS
Orë mësimore në auditor	2240 orë
Orë mësimore jashtë auditorit	2260 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin “Master Profesional” të Fakultetit është si më poshtë

Kohëzgjatja e studimeve	1.5 vite akademike 3 simestra 45 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	90 ECTS
Orë mësimore në auditor	1125 orë
Orë mësimore jashtë auditorit	1125 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin “Master i Shkencave” të Fakultetit është si më poshtë:

Kohëzgjatja e studimeve	2 vite akademike 4 simestra 60 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	120 ECTS
Orë mësimore në auditor	1500 orë
Orë mësimore jashtë auditorit	1500 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

b) Statistikat e pranimit në Fakultet, sistemi me kohë të plotë, Niveli Bachelor, viti akademik 2016-2017, janë si më poshtë:

Pranimet e reja + transferime kreditesh (statistika të pranimit për çdo program studimi, nr. aplikimesh, të pranuar, niveli cilësor i pranimeve nota mesatare)

NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	APLIKIME	PRANIME	NIVELI CILËSOR	TRANSFERIME	
				NOTA MESATARE	BRENDA UNIKO	JASHTË UNIKO
1.	GJUHË ANGLEZE	252+290	51	7.8	1	
2.	GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	22+24	20	7.1		1
3.	GJUHË LETËRSI	386+374	31	7.3		
4.	HISTORI-GJEOGRAFI	386+383	44	7.4	1	
5.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	407+355	40	7.3	1	
6.	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	274+213	21	7.07		

Raport i vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programeve të ciklit të parë “Bachelor” dhe të ciklit të dytë “Master” në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë

2016-2017

7.	MËSUESI NË HISTORI-GJEOGRAFI (MP)		57	7.1		
8.	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË ANGLEZE “ ME PROFIL MINOR NË ARTE(MP)		38	6.6		
9.	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË LETËRSI“ ME PROFIL MINOR NË ARTE(MP)		64	6.4		
10.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR (KLASA I-VI)(MSH)		41	6.4		

c) *Numri i studentëve për çdo kurs studimi sipas Programeve të studimit, Niveli Bachelor dhe Master, për vitin akademik 2016-2017. (Me kohë të pjesshme nëse ka)*

NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	FORMA KP/KPJ	B/MP/ MSC	VITI I			VITI II			VITI III			VITI IV		
				F	M	GJITHSEJ	F	M	GJITHSEJ	F	M	GJITHSEJ	F	M	GJITHSEJ
				1.	GJUHË ANGLEZE	KP	BA	42	10	52	33	15	48	31	24
2.	GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	KP	BA	18	2	20	4	1	5						
3.	GJUHË LETËRSI	KP	BA	21	11	32	31	16	47	57	11	68			
4.	HISTORI-GJEOGRAFI	KP	BA	31	12	43	33	20	53	44	19	63			
5.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	KP	BA	35	6	41	44	16	60	40	22	62			
6.	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	KP	BA	21		21	33	1	32	30		30			
7.	GJUHË LETËRSI	KPJ	BA										9	3	12
8.	HISTORI-GJEOGRAFI	KPJ	BA										16	14	30
9.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	KPJ	BA										12	3	15
10.	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	KPJ	BA										19		19
11.	MËSUESI NË HISTORI-GJEOGRAFI	KP	MP	44	13	57	30	13	43						
12.	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË ANGLEZE “ ME PROFIL MINOR NË ARTE	KP	MP	26	11	37	29	18	47						
13.	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË LETËRSI“ ME PROFIL MINOR NË ARTE	KP	MP	45	19	64	35	11	46						
14.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR (KLASA I-VI)	KP	MSC	29	11	40	39	12	51						

d) Kalueshmëria sipas programeve të studimit, Niveli Bachelor. Viti akademik 2016-2017 (Sistemi me kohë të pjesshëm nëse ka)

Programi i Studimit	Forma e Studimit (KP/KPJ)	Cikli i Studimit BA/MP, Msc	VITI 1	VITI 2	VITI 3	VITI 4
			Kalueshmëria në %			
GJUHË ANGLEZE	KP	BA	96%	92%	62%	
GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	KP	BA	100%	100%		
GJUHË LETËRSI	KP	BA	77.4%	96%	51%	
HISTORI-GJEOGRAFI	KP	BA	97.7%	93%	65%	
MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	KP	BA	91.8%	88%	51%	
MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	KP	BA	100%	79%	51%	
GJUHË LETËRSI	KPJ	BA				84.6%
HISTORI-GJEOGRAFI	KPJ	BA				70%
MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	KPJ	BA				93%
MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	KPJ	BA				78.9%
MËSUESI NË HISTORI-GJEOGRAFI	KP	MP	73%	92%		
MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË ANGLEZE “ ME PROFIL MINOR NË ARTE	KP	MP	55%	73%		
MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË LETËRSI“ ME PROFIL MINOR NË ARTE	KP	MP	64%	80%		
MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR (KLASA I-VI)	KP	MSC	75%	97%		

N r	PROGRAMI I STUDIMIT	CIKLI I STUDIMIT	KALUESHMËRIA NË % 2016-2017	STUDENTË TË DIPLOMUAR 2016-2017	NOTA MES. E TË DIPLOMUARVE 2016-2017
1.	GJUHË ANGLEZE	BA	70.3%	30	7.06
2.	GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	BA	100%	-	-
3.	GJUHË LETËRSI	BA	65.4%	37	7.24
4.	HISTORI-GJEOGRAFI	BA	74.2%	46	6.69
5.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	BA	71.2%	24	6.05
6.	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	BA	69.3%	17	6.15
7.	MËSUESI NË HISTORI-GJEOGRAFI	MP	82.5%	45	7.46
8.	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË ANGLEZE “ ME PROFIL MINOR NË ARTE	MP	64%	34	6.83
9.	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË LETËRSI“ ME PROFIL MINOR NË ARTE	MP	72%	37	7.24
10.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR (KLASA I-VI)	MSC	65%	44	6.96

Të diplomuar gjithsej për vitin akademik 2016-2017 në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të studimeve

Programet e studimit	Sistemi 3 -vjeçar Bachelor	Sistemi me kohë të pjesshme	Master	Gjithsej (Sipas programeve të studimit)
GJUHË ANGLEZE	30			30
GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	-			-
GJUHË LETËRSI	20	19		39
HISTORI-GJEOGRAFI	46	37		83
MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	24	25		49
MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	17	16		33
MËSUESI NË HISTORI-GJEOGRAFI			45	45
MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË ANGLEZE “ ME PROFIL MINOR NË ARTE			34	34
MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË LETËRSI“ ME PROFIL MINOR NË ARTE			37	37
MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR (KLASA I-VI)			44	44

NR	PROGRAMI I STUDIMIT		TË DIPLOMUAR NË 3 VITET E FUNDIT
	GJUHË ANGLEZE	KP	110
	GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	KP	14
	GJUHË LETËRSI	KP	157
	HISTORI-GJEOGRAFI	KP	170
	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	KP	116
	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	KP	43
	CIKELI ULET (FILIALI POGRADEC)	KP	67
	GJUHË LETËRSI	KPJ	49
	HISTORI-GJEOGRAFI	KPJ	37
	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	KPJ	52
	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	KPJ	39
	MËSUESI NË HISTORI-GJEOGRAFI	KP	77
	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË ANGLEZE “ ME PROFIL MINOR NË ARTE	KP	74
	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË LETËRSI“ ME PROFIL MINOR NË ARTE	KP	178
	MASTER PROFESIONAL MESUESI PER CIKLIN EULET	KP	94
	MASTER PROFESIONAL NE MESIMDHENIE	KP	1
	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR (KLASA I-VI)	KP	219

IV - PROGRAMET E STUDIMIT, ORGANIZIMI I KURRIKULAVE, KREDITET

Rregulloret mësimore të programeve të studimit “Bachelor” dhe “Master” janë hartuar nga departamentet përkatëse, duke u mbështetur edhe në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe ato të fakulteteve homologe, duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve.

Këto rregullore paraqesin në mënyrë të plotë kriteret dhe procedurat e ndarjes së ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit, disiplinat e formimit në secilin program studimit, personelin akademik përgjegjës dhe infrastrukturën në dispozicion të programeve. Ato pasqyrojnë gjithashtu mënyrat e vlerësimit të studentit, rregullat dhe procedurat e diplomimit, si dhe format e mësimdhënies të përshkruara në syllabuset lëndore që e shoqërojnë.

Më konkretisht, rregullorja mësimore e një programi studimi përcakton në veçanti:

- a.-listën e disiplinave mësimore, të ndara në module si dhe veprimtari të tjera formuese;
- b.-objektivat formues specifikë të çdo disipline apo veprimtarie tjetër formuese;
- c.-kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë mësimore apo veprimtari tjetër formuese;
- ç.-kurrikulat që u ofrohen studentëve;
- d.-format e studimit, të provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët;
- f.-detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin;
- g.-kushtet për procedurat dhe modalitetet për transferimin e studentëve.

Në planin mësimor është synuar të ruhet një raport i drejtë midis formimit të përgjithshëm, formimit bazë dhe atij profesional të studentëve për të gjitha nivelet. Rregulloret janë hartuar konform përcaktimeve të Rregullores së Studimeve të Universitetit “Fan S. Noli”.

Planet mësimore të secilit cikël organizohen, mbështetur në Deklaratën e Bolonjës, ku thelbësor mbetet “Sistemi evropian i transferimit të krediteve”, ECT (European Transfer System), i cili bën të mundur matjen e të mësuarit dhe arritjet e tij, si dhe ka në qendër ngarkesën e punës që studenti duhet të kryejë për të arritur objektivat e programit të tij të studimit. Ndërkohë që notat 4 -10 shprehin cilësinë e punës së studentit, kreditet masin dhe tregojnë sasinë e punës së kryer nga studenti. Studenti, nëse kërkon të transferohet, mund t’i transferojë kreditet e tij në një universitet tjetër partner. Universiteti partner përcaktohet mbi bazën e marrëveshjeve institucionale me universitetet e tjera. Përvijueshmëria e programeve të studimit ka lidhje të drejtpërdrejtë edhe me bashkëpunimin e ngushtë me organet e pushtetit vendor dhe me grupet e interesuara nga komuniteti gjë që i paraprin hapjes së programeve të reja në ciklet aktuale të studimit dhe në programet e trajnimit dhe ritrajnimit të specialistëve lokalë nëpërmjet përvojës që ofron Qendra e Ekselencës.

- a) Programet e studimit janë ndërtuar mbi udhëzimet paraprake të MAS-it.
- b) plotësojnë synimin për të përgatitur profesionistë të edukimit të nivelit të parë dhe të specializuar në fushat përkatëse, kryesisht për tregun e punës brenda vendit, por dhe jashtë tij, konceptuar sipas Procesit të Bolonjës;
- c) është konceptuar si një model që kombinon standardet akademike me nevojat reale të profesionit (integrimi i njohurive teorike me kërkimin dhe praktikën pedagogjike-profesionale)
- e) paraqet një ofertë akademike elastike që ndërtohet duke mbajtur parasysh kërkesat e tregut për profesionistë të edukimit në fusha

të ndryshme, përvojën aktive dhe interesat e studentëve; f) i përgatit studentët për të dhënë ndihmesën e tyre për një edukim më cilësor dhe shoqëri më të drejtë;

g) ka të integruar dimensionin ndërkomëtar.

Secili prej programeve ka përcaktuar objektiva që përputhen me strategjinë e zhvillimit të institucionit, objektiva që janë të shprehur qartë, të realizueshëm dhe të matshëm. Për çdo disiplinë apo modul hartohen programe mësimore të cilat përmbajnë:

-emrin e pedagogut që e zhvillon disiplinën (modulin);

-emërtimin e disiplinës/e modulit;

-vitin/semestrin kur zhvillohet disiplina (moduli) ;

-numrin e orëve në auditor (leksione, seminare, ushtrime etj.)

-numrin e krediteve;

-ç’veprimtarie formuese i përket kjo disiplinë (e formimit të përgjithshëm, karakterizues etj.)

-objektivat specifikë të kësaj disipline (moduli);

-temat kryesore dhe çështjet për çdo temë; -format dhe metodat e mësimdhënies;

-format e vlerësimit të studentëve (provime me gojë a me shkrim, verifikime të dijeve gjatë zhvillimit të lëndës etj.);

-detyrimet e studentit për lëndën (frekuentimi, detyrë kursi, kolokuiumi etj);

-literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Programet mësimore hartohen nga titullari i disiplinës ose grup pedagogësh, shqyrtohen në departament dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Mbështetur në programin e studimit të licencuar BA për mësues të arsimit parauniversitar në profilet që mbulon Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe përmirësimin e tij akademik kërkimor, studentët e nivelit BA zhvillojnë si më poshtë:

a. Lëndë të formimit bazë (A)

b. Lëndë të formimit karakterizues (B)

c. Veprimtari të disiplinave integruese (C)

d. Disiplina me zgjedhje të studentit, ndër disiplinat e ofruara nga institucioni (D)

e. Njohuri të tjera formuese, si plotësime në gjuhë të huaj, informatikë, prezantuese, stazh apo praktika, etj. (E);

f. Praktikë pranë institucioneve shkollore (F);

g. Teza e diplomës (G).

Nr.	Cikli i studimit	Emërtimi i programit	Nr i lëndëve sipas tipit të veprimtarisë ¹					
			A	B	C	D	E	F
1	Bachelor	GJUHË ANGLEZE	8	18	4	9	5	1
2	Bachelor	GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	6	21	6	8	7	1
3	Bachelor	GJUHË LETËRSI	8	17	7	10	5	1
4	Bachelor	HISTORI-GJEOGRAFI	2	16	8	6	3	1
5	Bachelor	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	5	15	5	1	4	1
6	Bachelor	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	6	16	4	2	3	1
7	Master profesional	MËSUESI NË HISTORI-GJEOGRAFI	3	9	3	2	3	1
8	Master profesional	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË ANGLEZE “ ME PROFIL MINOR NË ARTE	3	10	2	3	5	1
9	Master profesional	MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË “GJUHË LETËRSI“ ME PROFIL MINOR NË ARTE	4	7	3	3	2	1
10	Master i Shkencave	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR (KLASA I-VI)	3	10	5	2	3	1

¹ I referohet tipit të veprimtarisë për lëndët në rregulloret e programeve të studimit

V - STAFI MËSIMDHËNËS DHE MBËSHTETËS.

a) *Stafi mësimdhënës dhe mbështetës* në Fakultetin...

b) *Numri i stafit të brendshëm me kohë të plotë për vitin akademik 2016-2017* është si më poshtë:

Viti akademik	Numri i pedagogëve
2016-2017	49

c) *Raporti midis stafit mësimdhënës dhe numrit të studentëve për çdo kurs studimi në vitin akademik 2016-2017:*

NR.	PROGRAMET E STUDIMIT	RAPORTI STAF		
		I BRENDSHËM / I JASHTËM	STAF/ STUDENT	I KUALIFIKUAR/ I PAKUALIFIKUAR
1.	GJUHË ANGLEZE	19/3	1/8	20/2
2.	GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	7/2	1/4	8/1
3.	GJUHË LETËRSI	16/0	1/10	16/0
4.	HISTORI-GJEOGRAFI	11/5	1/10	11/5
5.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR KLASA I-VI	16/3	1/9	17/2
6.	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	16/3	1/7	16/3
7.	MËSUESI NË HISTORI- GJEOGRAFI	14/2	1/10	14/2
8.	MËSUESI PËR AML NË “GJUHË ANGLEZE “ ME PROFIL MINOR NË ARTE	19/2	1/7	20/1
9.	MËSUESI PËR AML NË “GJUHË LETËRSI“ ME PROFIL MINOR NË ARTE	15/4	1/8	18/1
10.	MËSUESI PËR ARSIMI FILLOR (KLASA I-VI) MSH	15/2	1/8	17/0

ç) *Mbulimi i lëndëve me pedagogë*

86 % të orëve mbulohen me pedagogë të brendshëm dhe 14% me pedagogë të ftuar

d) *Ngarkesa mësimore për lëndët e çdo kursi studimi*

*Ngarkesa fizike e stafit të brendshëm në programin **BACHELOR***

Stafi i brendshëm	Titulli/ Grada	Ngarkesa fizike MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR						
		<100	100- 200	200- 300	300- 400	400- 500	500- 600	>600
IRENA NIKAJ	Prof.as.dr	1						
ALBINA PAJO	Dr.		1					
ANJEZA VILA	Msc.			1				
ARJAN KAMBURI	Msc.	1						
DONIKA DARDHA	Doc.Dr.	1						
EVJONDA PYLLI	Dr.		1					
ILIA BELLO	Msc.		1					
MARIELA BURDA	Doc.		1					

JONELA SPAHO	Prof.as.dr	1						
JOSIF MINGA	Prof.as.dr	1						
DHORI BETA	Msc.	1						
ALBA KREKA	Dr.	1						
SOTIRAQ MARKO	Msc.	1						
ARDIANA MIÇI	Msc	1						
ARSINELA XHARA	PhD		1					
SILVJA ÇOBANI	Msc		1					
Staf i jashtëm								
SHKËLQIM JAUPI	Aktor	1						
TATJANA CACA	Piktor	1						
BELKIZE SARAÇI	Ing.	1						

<i>Stafi i brendshëm</i>		<i>Ngarkesa fizike MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR</i>						
Emër Mbiemër	<i>Titulli/Grada</i>	<100	100-200	200-300	300-400	400-500	500-600	>600
IRENA NIKAJ	Prof.as.dr.	1						
ALBINA PAJO	Dr.		1					
ANJEZA VILA	Msc.			1				
ARJAN KAMBURI	Msc.			1				
EVJONDA PYLLI	Dr.		1					
ILIA BELLO	Msc.	1						
MARIELA BURDA	Doc.			1				
JONELA SPAHO	Prof.as.dr.	1						
JOSIF MINGA	Prof.as.dr.	1						
DHORI BETA	Msc.	1						
ILIR PALLA	Msc.	1						
ERINDA PAPA	Dr.	1						
SOTIRAQ MARKO	Msc.	1						
ARDIANA MIÇI	Msc	1						
ARSINELA XHARA	PhD	1						
ALBA KREKA	Dr.	1						
Staf i jashtëm								
KRISTAQ MOSKO	Msc.	1						
FIGENA NINI	Msc.	1						
BELKIZE SARAÇI	Ing.	1						

<i>Stafi i brendshëm</i>		<i>Ngarkesa fizike GJUHË-LETËRSI</i>						
Emër Mbiemër	<i>Titulli/Grada</i>	<100	100-200	200-300	300-400	400-500	500-600	>600
ALI JASHARI	Prof.dr.	1						
JONELA SPAHO	Prof.as.dr.		1					
DION TUSHI	Prof.as.dr.		1					
ELONA ÇEÇE	Prof.as.dr.		1					
ANYLA SARAÇI	Prof.as.dr.		1					
ERIS RUSI	Dr.		1					
LIRI SEITLLARI	Dr.		1					
ARSINELA XHARA	PhD.	1						
ILIR SHYTA	Dr.		1					
OLGER BRAME	Msc.			1				
NELI NAÇO	Msc.		1					
ALDA JASHARI	Dr.		1					
DANIELA STOICA	PhD.	1						
ALBINA PAJO	Dr.	1						
ERMA PEMA	Msc.	1						
DORELA KONOMI	Dr .	1						

<i>Stafi i brendshëm</i>		<i>Ngarkesa fizike GJUHË ANGLEZE</i>						
Emër Mbiemër	<i>Titulli/Grada</i>	<100	100-200	200-300	300-400	400-500	500-600	>600
PAVLLO CICKO	Prof.as.dr.	1						
ELONA ÇEÇE	Prof.as.dr.	1						
SUELA KOÇA	Dr.		1					
VASILIKA POJANI	Doc.	1						
EDLIRA XEGA	Dr.		1					
ERINDA PAPA	Dr.		1					
ALDA CICKO	Dr.		1					
BENITA STAVRE	Dr.		1					
OLSA PEMA	Dr.			1				
JULIANA ÇYFEKU	Dr.		1					
LINDITA KAÇANI	Dr.		1					
DORELA KACAUNI	Dr.		1					
LORENA ROBO	Dr.	1						
ERIOLA QAFZEZI	Dr.		1					
DANIELA STOICA	PhD.	1						
ALMA KARASALI	Dr.	1						
DHORI BETA	Msc.	1						
OLGER BRAME	Msc.	1						

ERIS RUSI	Dr.	1						
Staf i jashtëm								
HILDA LUBONJA	Doc.	1						
ZVJETLLANA POLENA	As.ped.	1						
ROVENA PILAJ	As.ped.	1						

<i>Stafi i brendshëm</i>		<i>Ngarkesa fizike GJUHË DHE KULTURË FRËNGE</i>						
Emër Mbiemër	<i>Titulli/Grada</i>	<100	100-200	200-300	300-400	400-500	500-600	>600
PAVLLO CICKO	Prof.as.dr.		1					
FABIOLA MUÇO	Dr.			1				
ROBERT STRATOBËRDHA	Doc.				1			
ELONA ÇEÇE	Prof.as.dr.	1						
ERIOLA QAFZEZI	Dr.		1					
LORENA ROBO	Dr.	1						
DANIELA STOICA	PhD	1						
ERIS RUSI	Dr.	1						
OLGER BRAME	Msc.		1					
LIRI SEITLLARI	Dr.	1						
OLSA PEMA	Dr.	1						
ALDA CICKO	Dr.	1						
DHORI BETA	Msc.	1						
Staf i jashtëm								
HILDA LUBONJA	Doc.	1						
ZVJETLLANA POLENA	As.ped.	1						

<i>Stafi i brendshëm</i>		<i>Ngarkesa fizike HISTORI-GJEOGRAFI</i>						
Emër Mbiemër	<i>Titulli/Grada</i>	<100	100-200	200-300	300-400	400-500	500-600	>600
SKËNDER ALIU	Prof.	1						
METIN VENXHA	PhD.			1				
ERMIONA BRAHOLLI	Dr.			1				
ERMIRA JASHIKU	Dr.			1				
FLORINA PAZARI	Dr.			1				
ALBA KREKA	Dr.				1			
LINDITA KIRI	Dr.		1					
SOKOL SUPARAKU/ ADELINA NEXHIPI	Dr.		1					
ORION AGO	Dr.				1			
EDLIRA MENKSHI	Dr.			1				
ARDIANA MICI	Dr.		1					
MITJANA PROFIRI	Msc.	1						

DHORI BETA	Msc.	1						
